

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor është një person juridik publik qendror nën varësinë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe ka si objekt të veprimtarisë së tij zhvillimin e artit dhe kulturës, ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare, realizimin e veprave skenike të autorëve shqiptarë dhe të huaj, eksperimentimin e formave të reja të shprehjes skenike, ruajtjen, zhvillimin, kultivimin e vlerave etnomuzikore e koreografike si dhe promovimin e tyre brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

TKOBAP, për të përmbushur sa më sipër, ka një strukturë të përbërë nga 5 drejtori të cilat janë nën varësinë e Drejtorit të Përgjithshëm:

- 1.Drejtoria e Operës dhe Filarmonisë
- 2.Drejtoria e Baletit
- 3.Drejtoria Artistike e Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore
- 4.Drejtoria e Produksionit Skenik
- 5.Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Historiku i institucionit sipas përshkrimit në menu: "Rreth nesh".

Drejtori i Përgjithshëm emërohet me Vendim të Këshillit të Ministrave pas propozimit të dhënë nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ndërsa punonjësit e tjerë sipas parashikimeve në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, i ndryshuar, Statutit dhe Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e TKOBAP-së” dhe klasifikimi i pagave sipas dy VKM-ve të publikuara në bazën ligjore të Programit të Transparencës.